

## **MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË DEGËN DOGANORE TIRANË**

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Degën Doganore Tiranë me objekt “Mbi realizimin e të ardhurave doganore dhe zbatimin e legjislacionit doganor” dhe për auditimin e insitucionit për vitin 2010 dhe 2011. Masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr.105, datë 30/06/2012.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 1/6/2000, me shkresën nr. 118/9, datë 30/06/2012 dërguar Z. Bujar Vukaj, Kryetar i Degës Doganore Tiranë, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

### **A. Masa për përmirësim legjislacioni**

Nga auditimi i zbatimit të ligjit nr. 8449, datë 27/01/1999 neni 197 pika 5 e tij ka rezultuar që dhënia e destinacionit doganor “Asgjësim” për produktin kompesues dytësor të përfituar në regjimet me përpunim aktiv. Ky është një destinacion që jepet për mallra të asgjësuar (asgjësim konsiderohet djegia, tretja apo procese të ndryshme që tjetërsojnë materien), hedhja nuk mund të jetë procedurë asgjësimi, edhe po të që i tillë hedhurinave që mbeten nga asgjësimi bazuar në pikën 5 të nenit 197 të Kodit Doganor duhet t’i caktohet një destinacion i ri doganor. Produkti kompesues dytësor është përfutur si pasojë e procesit të përpunimit të ndodhur në Shqipëri dhe nuk mund të gëzojë më origjinë preferenciale (apo të vendit nga është deklaruar në IM5), detyrimisht riklasifikohet në kod të ri tarifor. Nga analizimet që i kemi bërë problemit të mësipërm propozojmë:

Ministria e Financave në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit të hartojë akte nënligjore për të sanksionuar klasifikimin, vlerësimin empirik dhe mënyrat e qarkullimit të këtyre produkteve. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të nxjerrë një Udhëzim të detajuar për të përcaktuar qartë destinacionin doganor të mbetjeve, vendosje në qarkullim të lirë dhe për kodet e reja të klasifikimit të këtyre produkteve dytësore me një komision specialistësh të caktojë vlerën e tregut.

### **B. Masa organizative**

Autoriteti doganor kompetent të analizojë me të gjithë stafin Raportin Përfundimtar të Auditimit në të cilin janë paraqitur rast pas rasti shkeljet e konstatuara, njëkohësisht të përgatisë një program pune të veçantë me persona përgjegjës, për zbatimin e rekomandimeve të dërguara, bashkëlidhur këtij raporti

1. Dega e Doganës Tiranë në bashkëpunim me DPD të organizojë mbikqyrjen e rregjimeve ekonomike, përcaktimin dhe kontrollin e Koeficientëve të shfrytëzimit për lëndë të para dhe materialeve ndihmëse dhe aksesoreve. Gjithashtu në bashkëpunim të shfrytëzohet e gjithë baza ligjore fiskale dhe proceduriale në arritjen e një maksimizimi të ardhurash doganore, pa dëmtuar subjektin por duke e ndërgjegjësuar atë për efikasitetin e ndihmës. Duhet që “produkti kompesues dytësor të trajtohet jo me origjinë preferenciale, pasi është prodhuar në Shqipëri, dhe vlera në import e tij është eksportuar me produktin kompesues parësor”.

**Menjëherë**

2. Të përmirësohet më tej puna organizative për arkëtimin e detyrimeve debitore që lindin nga veprimtaria kontrolluese pas kryerjes së ç’doganimit, në periudhë kohore sa më të shkurtër, në respektim të vazhdueshëm të dispozitave ligjore, pa kaluar si detyrim në borxh. Të merren masat e duhura për arkëtimin me force të detyrimit, dhe të gjenden forma efikase të bashkëpunimit me Drejtoritë Rajonale të Tatimeve. Sektori i borxhit dhe i financës të bëjnë llogaritjen e kamat vonesave në momentin e konstatimit. Në drejtim të marrjes së masave për rikuperimin e borxhit nuk është e mjaftueshme vetëm dërgimi strukturave të Drejtorisë për bllokim në rrjet apo bankave, por njohja periodike e situatës financiare të subjektit nëpërmjet informacioneve për treguesit e bilanceve dhe të dhënëve të tjera që disponohen nga Drejtoritë Rajonale të Tatimeve.

**Menjëherë**

3. Lidhur me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, nga DDT të kërkojë që grupi i punës të mos mjaftohet vetëm me detajimin dhe shpërndarjen e problemeve sipas personave përkatës, por të ndjekë në vazhdimësi në vartësi me afatin e caktuar për zgjidhjen përfundimtare të rekomandimit duke siguruar nga personat përgjegjës një relacion me shkrim dhe të qartë nga pikpamja ligjore. Mbi këtë bazë duhet të hartohet nga grupi i punës një material përmbledhës shpjegues dhe të argumentuar për gjithë rekomandimet e lëna.

**Menjëherë**

4. Të kryhen trainime të herepashershme të doganierëve për klasifikimin tarifor dhe të mospranohen fatura të papërkthyer dhe të panoteruara nga subjektet.

**Menjëherë**

5. Përfaqësuesi i subjektit, Agjencia Doganore duhet të jetë subjekt i penalizimit për deklarime të tjetërsuara nga fatura, dhe të konsiderohët kjo si një ndëshkim i pandarë nga penalteti për subjektin ekonomik.

**Menjëherë**

### **C. Masa Zhdëmtimi**

1. Të saktësohen, kontabilizohen dhe të ndiqen procedurat ligjore për detyrime doganore të rezultuara dhe të pa llogaritura në deklaratat e mëposhtëme për:

- Deklarata R 31623 e datës 22-Qer-10 për shumën 88,068 lekë
- Deklarata R 72219 e datës 30-Dhj-10 për shumën 102,972 lekë
- Deklarata R 20117 e datës 27-Pri-10 për shumën 59,810 lekë
- Deklarata R 46822 e datës 04-Sht-10 për shumën 21,382 lekë
- Deklarata R 41937 e datës 26-Kor-11 për shumën 1,344,390 lekë

**Brenda datës 30.09.2012**

2. Të saktësohen, kontabilizohen dhe të ndiqen procedurat ligjore për detyrime doganore të rezultuara dhe të pa llogaritura në deklaratat IM9 në vlerë totale 10,725,340 lekë sipas aneksit2 bashkalidhur Raportit të Kontrollit.

**Brenda datës 31.12.2012**

3. Të kontabilizohen dhe të ndiqen procedurat ligjore për detyrime doganore të rezultuara dhe të pa llogaritura në deklarata doganore me një vlerë totale 482,330 lekë

**Brenda datës 30.09.2012**

### **D. Masa Disiplinore**

Bazuar në Vendimin nr.205, datë 13.4.1999 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar me vendimin Nr. 686, datë 02/11/2005 dhe në faktet e vërtetuara dhe në të dhënat e grumbulluara gjatë auditimit rekomandojmë Kryetarit të Doganës Tiranë t'i propozojë Komitetit disiplinor ndëshkimin me masën:

1. “Ulje një shkallë në kategori dhe transferim nga pozicioni i punës, 6 muaj” neni 18, pika 1.4, germa c, për gjashtë punonjës, për moszbatim të ligjit 8449 datë 27/01/1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, neni 140, neni 197 pika 5 VKM 205 datë 13/04/1999 Për Miratimin e Dispozitave zbatuese të Kodit Doganor neni 236 dhe neni 282, dhe shkelje të pikës 3 të autorizimeve të RPA-së dhe moszbatim të tyre. Për shkelje të konstatuara lidhur me koeficientin e shfrytëzimit, procedura doganore për kode të paautorizuara dhe produktet dytësore destinacioni doganor i tyre.

2. “Humbjen e së drejtës së shpërblimeve për 1 vit”, neni 18, pika 1.4, germa c, për gjashtë punonjës, për moszbatim të ligjit 8449 datë 27/01/1999 Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë nenet 34-39, udhëzimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave Nr.1 datë 25/01/2006, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.25 datë 30/11/2007 për përcaktimin e vlerës së automjeteve për qëllime të zhdoganimit si dhe për dispozitat zbatuese neni 15 pika 4 për klasifikimin e saktë tarifor.

**Shënim:** Auditimi u krye nga audituesit z. Alketa Përnaska, përgjegjës grupi, z. Aqif Klosi, anëtar, z. Bashkim Shehu, anëtar, z. Xhovan Domi, anëtar. Më tej u shqyrtua nga Kryeaudituesi i Departamentit z. Kristaq Gjurgjaj, Drejtori i Departamentit z. Kristaq Gjurgjaj dhe Drejtori i Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë z. Elvana Tivari, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm z. Robert Gjini.